



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 8 mars 2021
Nr.ref.:RK 1728/21

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI60/20

Parashtrues

Këshilli i Bashkësisë së Fesë Islame

Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.4738/19, të 23 janarit
2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Këshilli i Bashkësisë së Fesë Islame, me seli në Komunën e Gjakovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [AC.nr.4738/19] e 23 janarit 2020 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) në lidhje me Aktvendimin [PPP.nr.165/19] e 5 gushtit 2019 të Gjykatës Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit, përmes të cilit parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa Individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 7 prill 2020, parashtruesi i kërkesës, përmes postës dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 19 maj 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).
7. Më 12 qershor 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që në Gjykatë të dorëzojë Aktvendimin [PPP.nr.165/19] e 5 gushtit 2019 të Gjykatës Themelore. Të njëjtën ditë Gjykata, njoftoi edhe Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 30 qershor 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi para Gjykatës dokumentin e kërkuar.
9. Më 7 dhjetor 2020, Gjykata gjithashtu kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, të dorëzojë para Gjykatës (i)

Vendimin të cilin parashtuesi i kërkesës në kërkesën e tij pretendon se duhet të trajtohet si *res judicata*; dhe (ii) të gjitha dokumentet e tjera që janë relevante për trajtimin e rastit përkatës. Parashtuesi i kërkesës, nuk iu ka përgjigjur kërkesës së Gjykatës.

10. Më 18 shkurt 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve

11. Bazuar në shkresat e lëndës, rezulton se parashtuesi i kërkesës nuk kishte përmbushur obligimet financiare në vlerë prej 2,938.55 euro ndaj KRM “Çabrati” Sh.A., me seli në Komunën e Gjakovës (në tekstin e mëtejme: “Çabrati” Sh.A.). Evidenca e faturave të papaguara në emër të shërbimeve të bartjes së mbeturinave për vitet 2005, 2006, 2007 dhe një pjese të vitit 2008, respektivisht deri në muajin tetor, reflekton shumën e lartcekur.
12. Më 15 dhjetor 2008, “Çabrati” Sh.A., kishte paraqitur Propozim për Përmbarim në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Qarkut), kundër parashtuesit të kërkesës, për shkak të mospërmbushjes së obligimeve financiare të lartpërmendura.
13. Më 12 janar 2009, Gjykata e Qarkut, përmes Aktvendimit [E.nr.516/08] e kishte lejuar përmbarimin. Nga shkresat e lëndës, nuk është e qartë nëse kjo procedurë është e përfunduar.
14. Në një datë të pasaktësuar, “Çabrati” Sh.A., ndaj parashtuesit të kërkesës kishte paraqitur padi në Gjykatën Themelore, lidhur me pagesën e borxhit në vlerë prej 2.021,70 euro në emër të shërbimeve të bartjes së mbeturinave për vitet 2005, 2006, 2007 dhe një pjese të vitit 2008.
15. Më 5 nëntor 2018, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [C.nr.332/2018], aprovoi padinë e “Çabrati” Sh.A., duke e detyruar parashtuesin e kërkesës që të paguaj borxhin e lartcekur.
16. Në një datë të pasaktësuar, “Çabrati” Sh.A., kishte iniciuar përmbarimin tek Përmbaruesi Privat G.G.J., sipas dokumentit përmbarimor, përkatësisht Aktgjykimit [C.nr. 332/2018] të 5 nëntorit 2018 të Gjykatës Themelore, i cili, sipas shkresave të lëndës, ishte bërë i ekzekutueshëm më 25 prill 2019.
17. Më 8 maj 2019, Përmbaruesi Privat, në bazë të Urdhrit [P.nr.245/19], kishte lejuar përmbarimin e propozuar nga “Çabrati” Sh.A., ndaj parashtuesit të kërkesës.
18. Në një datë të pasaktësuar, kundër Urdhrit të lartcekur, parashtuesi i kërkesës kishte ushtruar prapësim në Gjykatën Themelore, duke pretenduar shkelje të esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtuesi i kërkesës, në esencë, kishte theksuar se propozimi për përmbarim është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (në

tekstin e mëtejshëm: LPP) dhe gjithashtu e kishte kontestuar lartësinë e borxhit dhe kishte pretenduar parashkrimin e tij.

19. Më 5 gusht 2019, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PPP.nr.165/19], kishte refuzuar si të pabazuar prapësimin e parashtruesit të kërkesës, duke theksuar se (i) bazuar në nenin 21 (Bazat juridike për caktimin e përmbarimit) të LPP-së është paraparë që organi përmbarues e cakton dhe e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues dhe në rastin konkret, “Çabrati” Sh.A., kishte kërkuar përmbarimin e Aktgjykimit [C.nr.332/2018] të 5 nëntorit 2018 të Gjykatës Themelore, i cili ishte bërë i plotfuqishëm më 22 mars 2019 dhe i ekzekutueshëm më 25 prill 2019; dhe (ii) bazuar në paragrafin 1 të nenit 71 (Shkaqet e prapësimit) në ndërlidhje me nenin 21 (Bazat juridike për caktimin e përmbarimit) dhe paragrafit 1.1 të nenit 22 (Dokumenti përmbarues) të LPP-së, në rrethanat e rastit konkret, dokumenti përmbarues ka titull ekzekutiv dhe ka tipare të përmbarueshmërisë, dhe se pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës, të paraqitura përmes prapësimit, nuk hyjnë në shkaqet e tjera të përcaktuara përmes nenit 71 të LPP-së.
20. Në një datë të pasaktësuar, kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që i njëjti të kthehet në rivendosje. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kishte pretenduar se borxhi i cili kërkohet të realizohet është parashkruar, pasi që i njëjti daton që nga viti 2006 dhe për pasojë, është i vjetërsuar.
21. Më 23 janar 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.4738/19], refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin e lartcekur të Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit, në arsyetimin e saj, ndër të tjera, theksoi se (i) përmbarimi është lejuar duke u bazuar në dokumentin përmbarues, përkatësisht Aktgjykimin [C.nr.332/2018] e 5 nëntorit 2018 të Gjykatës Themelore, i cili ishte bërë i plotfuqishëm më 22 mars 2019 dhe i ekzekutueshëm më 25 prill 2019; dhe (ii) se bazuar në paragrafin 1 të nenit 361 (Kërkesat e vërtetuara nga gjykata ose organet e tjera kompetente) të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në tekstin e mëtejshëm: LMD), “*kërkesa për përmbarim nuk është parashkruar*”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi [Ac.nr.4738/19] i 23 janarit 2020 i Gjykatës së Apelit, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
23. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të neneve të lartcekura të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës thekson se (i) kjo çështje duhet të trajtohet si *res judicata* sepse “*kreditori ka iniciuar një procedurë përmbarimore në vitin 2008 në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë e cila çështje evidencohet si (E.nr.516/08)*”, dhe se për pasojë, “*procedura përmbarimore është ende e hapur, dhe se kreditori nuk ka pasur mundësi të inicioj procedurë përmbarimore të re pa*

e tërhequr të parën, përkatësisht është dashur të paraqes kërkesë për transferimin e lëndës tek përmbaruesi privat”; (ii) Aktvendimi i kontestuar është nxjerrë në shkelje të pikës n) të paragrafit 2 pika të nenit 182 [pa titull] të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurë Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK); dhe (iii) se në rrethanat e rastit, bazuar në parimin “lex specialis derogat lex generali”, duhet të jetë aplikuar Ligji nr.05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike (në tekstin e mëtejme: Ligji për Faljen e Borxheve) dhe bazuar në të cilin, “përfshihet falja e borxheve dhe ndëshkimeve deri më 31 dhjetor 2008, e që në këtë rast dëmi është shkaktuar në dt. 30.12.2008 dhe ky dëm duhet të përfshihet në falje në tërësi”.

24. Parashtruesi i kërkesës, në fund, kërkon nga Gjykata që (i) kërkesa e tij të shpallet e pranueshme; dhe (ii) të konstatohet se Aktvendimi [AC.nr.4738/19] i 23 janarit 2020 i Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktvendimin [PPP.nr.165/19] e 5 gushtit 2019 të Gjykatës Themelore, janë nxjerrë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

25. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

27. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”

28. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejné si për individët ashtu dhe personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme. (Shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës KI118/18, *me parashtrues, Eco Construction sh.p.k.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 tetorit 2019, paragrafi 29 dhe referencat e përdorura aty).
29. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë siç janë të përcaktuara me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”

Në kontekst të dispozitave të lartcekura, Gjykata thekson se bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 1 të nenit 47 dhe nenin 48 të Ligjit, përpos specifikimit të aktit konkret të autoritetit publik i cili kontestohet, palët janë gjithashtu të detyruara që të qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqesin faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren që parashtruesi i kërkesës, përkundër kërkesave të Gjykatës për sqarim, nuk ka dorëzuar para Gjykatës dokumentacionin e kërkuar, bazuar në të cilin, kërkesa e tij para Gjykatës do të sqaronte në mënyrë adekuate edhe rrethanat faktike të rastit e edhe pretendimet e tij përkitazi me të drejtat dhe liritë themelore të cilat pretendon se i janë cenuar.

30. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se kërkesën e parashtruesit të kërkesës e kishte pranuar më 7 prill 2020. Duke marrë parasysh që kërkesa nuk ishte e kompletuar, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 22 (Procedimi i kërkesës) të Ligjit dhe pikat (f) dhe (g) të paragrafit (2) të rregullit 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve) të Rregullores së punës, Gjykata fillimisht kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që në Gjykatë të dorëzojë Aktvendimin [PPP.nr.165/19] e 5 gushtit 2019 të Gjykatës Themelore. Parashtruesi i kërkesës, e dorëzoi këtë vendim në Gjykatë. Megjithatë, duke marrë parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës, më 7 dhjetor 2020, Gjykata iu drejtua sërish parashtruesit të kërkesës duke kërkuar që, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, të dorëzojë para Gjykatës (i) Vendimin të cilin parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij pretendon se duhet të trajtohet si *res judicata*; dhe (ii) të gjitha dokumentet e tjera që janë relevante për trajtimin e rastit përkatës. Parashtruesi i kërkesës, nuk iu ka përgjigjur kërkesës së Gjykatës.
31. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet paragrafit (5) të rregullit 35 të Rregullores së punës, i cili përcakton si në vijim:

Rregulli 35
(Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës)

[...]

“(5) Gjykata mund të vendosë të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave të Gjykatës ndaj palës që të plotësojnë apo qartësojnë kërkesën.”

[...]

32. Gjykata thekson se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës, i mundëson Gjykatës që të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër nëse, ndër të tjera, kërkesa e një parashtruesi është e paplotë dhe e paqartë, përkundër kërkesave të Gjykatës për të plotësuar dhe qartësuar kërkesën përkatëse. Gjykata i është drejtuar parashtruesit të kërkesës me kërkesës për të plotësuar dhe për të qartësuar kërkesën e tij, pa sukses.
33. Gjykata rithekson se në rrethanat e rastit konkret, pretendimi kryesorë i parashtruesit të kërkesës është që Aktvendimi [E.nr.516/08] i 12 janarit 2009 i Gjykatës së Qarkut, është bërë *res judicata*. Bazuar në shkresat e lëndës, rezulton se ky Aktvendim mund të ketë lejuar përmbarimin kundër parashtruesit të kërkesës. Megjithatë, përkundër kërkesës së Gjykatës, ky Aktvendim nuk është dorëzuar në Gjykatë. Për më tepër, në Gjykatë nuk janë dorëzuar as (i) Aktgjykimi [C.nr.332/2018] i 5 nëntorit 2018 i Gjykatës Themelore; dhe as (ii) Urdhri [P.nr.245/19] i 8 majit 2019 i Përmbaruesit Privat, vendime këto të cilat janë nxjerrë pas një vendimi të Gjykatës së Qarkut, që parashtruesi i kërkesës, pretendon të jetë *res judicata*.
34. Para Gjykatës, është dorëzuar vetëm Aktvendimi [AC.nr.4738/19] i 23 janarit 2020 i Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimi [PPP.nr.165/19] i 5 gushtit 2019 i Gjykatës Themelore, vetëm pas kërkesës së Gjykatës, ndërsa, edhe përkundër kërkesës së Gjykatës të 7 dhjetorit 2020, në Gjykatë nuk janë dorëzuar dokumentet e tjera relevante, përfshirë (i) prapësimin e parashtruesit të kërkesës, të ushtruar kundër Urdhrit [P.nr.245/19] të 8 majit 2019 të Përmbaruesit Privat; dhe (ii) ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit [PPP.nr.165/19] të 5 gushtit 2019 të Gjykatës Themelore, bazuar në të cilat, Gjykata do të mund t'i shqyrtonte edhe pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës e që ndërliidhen me shkeljen e dispozitave të LPK-së dhe Ligjit për Faljen e Borxheve.
35. Gjykata rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesës, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit e kërkesës nuk i përgjigjen kërkesave të Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata, i refuzon këto kërkesa me procedurë të shkurtër. (Shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI90/20, me parashtrues *Arben Boletini*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 25; dhe rastet nr. KI78/20, KI79/20 dhe KI80/20, me parashtrues *Hilmi Aliu dhe të tjerët*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 7 dhjetorit 2020, paragrafi 33 dhe referencat e përdorura aty).
36. Në rrethana kur një kërkesë para Gjykatës është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave të saj ndaj parashtruesit të kërkesës që të plotësojë apo qartësojë

kërkesën, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës, nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejme, për shkak se është e paplotë dhe e paqartë, siç është përcaktuar në paragrafin (5) të rregullit 35 të Rregullores së punës.

37. Prandaj dhe përfundimisht, në përputhje me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, kërkesa refuzohet me procedurë të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 22, 47 e 48 të Ligjit dhe rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, më 18 shkurt 2021, njëzëri:


VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka-Nimani

Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

Arta Rama-Hajrizi